UBLIKA E SHQIPERISE
TERIA TIRANE
ter: Robert KOLI
udio: Rr. "Urani Pano" Pa. 11 katesh
r. 17816 Rep.
Nr. 3191 Kol.

# KONTRATE SHITJE AKSIONESH

Ne Tirane, sot me date 27/10/2006(dymije e gjashte), para meje noter Robert KOLI, me seli si me siper, u paraqiten personalisht:

**Z. SHYQYRI DURAKU**, i biri i Alushit, lindur ne Kukes me 08/12/1954 dhe banim ne Tirane, Rr. Kavajes, Nr. 58, mbajtes i passaportes me nr. 06087763, ketu me poshte referuar si **Shitesi;**

Dhe

**Z. AVNI PONARI**, i biri i Rexhepit, lindur ne Tropoje me 28/07/1957 dhe banim ne Tirane, Bul Marsel Kashen, Pall. 1, Ap.12, ketu me boshte referuar si **Bleresi.**

Te cilet me kerkuan redaktimin e kesaj kontrate si vijon:

**MEQENESE**

**Shitesi, Shyqyri Duraku**, eshte aksioner ne shoqerite e sigurimeve:

1. "SIGAL" sh.a. person juridik shqiptar krijuar si i tille me Vendim te Gjykates se Rrethit Tirane Nr. 20863, date 22.02.1999, me adrese ne Tirane, Bulevardi "Zog I", Nr.1, me dege ne Kosove dhe kompani bije ne Maqedoni. Ne kete shoqeri shitesi Shyqyri Duraku zoteron 32 000(tridhjete e dy mije) aksione (26.40%), pronesia mbi te cilat vertetohet me Vendim Gjykate te Rrethit Tirane Nr.20863/12 date 27/10/2006 dhe Ekstrakt i Rregjistrit te Aksioneve leshuar nga Qendra e Rregjistrimit te Aksioneve sh.a. Tirane;

2. "SIGAL LIFE" sh.a. person juridik shqiptar krijuar si i tille me Vendim te Gjykates se Rrethit Tirane Nr. 32018, date 03.09.2004, me adrese ne Tirane, Bulevardi "Zog I", Pall. Diplomateve Nr.57. Ne kete shoqeri shitesi Shyqyri Duraku zoteron 47 520(dyzete e shtate mije e peseqind e njezet) aksione (26.40%), pronesia mbi te cilat vertetohet me Vendim Gjykate te Rrethit Tirane Nr.32018/2 date 22/06/2006;

**Shitesi, Shyqyri Duraku,** ka vendosur te shes pjese te aksioneve qe ai zoteron ne te dyja shoqerite "SIGAL" sh.a.(me efekt ne degen ne Kosove dhe kompanine bije ne Maqedoni) dhe "SIGAL LIFE" sh.a

**Bleresi, Avni Ponari** eshte aksioner ne shoqerite e sigurimeve:

1. "SIGAL" sh.a. person juridik shqiptar krijuar si i tille me Vendim te Gjykates se Rrethit Tirane Nr. 20863, date 22.02.1999, me adrese ne Tirane, Bulevardi

"Zog I", Nr.1, me dege ne Kosove dhe kompani bije ne Maqedoni. Ne kete shoqeri bleresi Avni Ponari zoteron 35 200 aksione (29.04%), pronesia mbi te cilat vertetohet me Vendim Gjykate te Rrethit Tirane Nr.20863/12 date ___/___/2006 dhe Ekstrakt i Rregjistrit te Aksioneve leshuar nga Qendra e Rregjistrimit te Aksioneve sh.a. Tirane;

2. "SIGAL LIFE" sh.a. person juridik shqiptar krijuar si i tille me Vendim te Gjykates se Rrethit Tirane Nr. 32018, date 03.09.2004, me adrese ne Tirane, Bulevardi "Zog I", Pall. Diplomateve Nr.57. Ne kete shoqeri bleresi Avni Ponari zoteron 52 272(pesedhjete e dy mije e dyqind e shtatedhjete e dy) aksione (29.04%), pronesia mbi te cilat vertetohet me Vendim Gjykate te Rrethit Tirane Nr.32018/2 date 22/06/2006 dhe Ekstrakt i Rregjistrit te Aksioneve leshuar nga Qendra e Rregjistrimit te Aksioneve sh.a. Tirane;

**Bleresi, Avni Ponari** deshiron dhe eshte dakort te blej pjese te aksioneve te zoteruar nga Shitesi Shyqyri Duraku ne te dyja shoqerite "SIGAL" sh.a.(me efekt ne degen ne Kosove dhe kompanin bije ne Maqedoni) dhe "SIGAL LIFE" sh.a. nepermjet nenshkrimit dhe shlyerjes, sipas kushteve dhe afateve te kesaj Kontrate.

**ATEHERE** Palet bien dakort si vijon:

***Neni 1 – Objekti i Kontrates***

Objekti i kesaj Kontrate eshte shitja e:

1. 19 878(netembedhjete mije e teteqind e shtatdhjete e tete) aksioneve – (16.40%) qe Shitesi zoteron ne shoqerine "SIGAL" sh.a. nga Z. Shyqyri Duraku tek Z.Avni Ponari;
2. 29 520(njezet e nente mije e peseqind e njezete) aksioneve – (16.40%) qe Shitesi zoteron ne shoqerine "SIGAL LIFE" sh.a. nga Z. Shyqyri Duraku tek Z.Avni Ponari;

***Neni 2- Cmimi i shitjes***

Palet e kesaj kontrate kane rene dakort qe numri i aksioneve te percaktuara ne Objektin e kesaj kontrate, referuar te dyja shoqerive "SIGAL" sh.a. dhe "SIGAL LIFE" sh.a. do te shitet per nje cmim total prej 3.3milion Euro.

***Neni 3- Menyra e shlyerjes se Cmimit te Aksioneve***

Palet bien dakort qe pagesa e cmimit te aksioneve te behet ne 3(tre)keste.
Kesti i pare prej 1 000 000(nje milion) Euro do te paguhet brenda dates 15 Nentor 2006.
Kesti i dyte prej 1 500 000(nje milion e peseqind mije)Euro do te paguhet brenda dates 30 Nentor 2006.Kesti i trete prej 800 000(teteqind mije)Euro do te paguhet brenda dates 30 Dhjetor2006.

***Neni 4- Perqindjet aksionere pas nenshkrimit te kesaj Kontrate***

**...as nenshkrimit te kesaj Kontrate dhe kryerjes se pageses se rene dakort si ne ...n 3 me larte gjendja e aksioneve ne shoqerite "SIGAL" sh.a. dhe ...AL LIFE" sh.a. te Z. Shyqyri Duraku paraqitet si vijon:**

| | | |
|---|---|---|
| ...GAL" sh.a. | - | 12 122(dymbedhjete mije e njeqind e njezet e dy) aksione (10.00%) |
| ...SIGAL LIFE" sh.a. | - | 18 000(tetembedhjete mije) aksione (10.00%) |

**4.2 Pas nenshkrimit te kesaj Kontrate dhe kryerjes se pageses se rene dakort si ne Nenin 3 me larte gjendja e aksioneve ne shoqerite "SIGAL" sh.a. dhe "SIGAL LIFE" sh.a. te Z. Avni Ponari paraqitet si vijon:**

| | | |
|---|---|---|
| "SIGAL" sh.a. | - | 55 078(pesedhjete e pese mije e shtatedhjete e tete) aksione (45.44%) |
| "SIGAL LIFE" sh.a. | - | 81 792(tetedhjete e njemije e shtateqind e nentedhjete e dy)aksione(45.44%) |

***Neni 5- Transferimi i pronesise mbi aksionet***

Me nenshkrimin e kesaj Kontrate referuar pikes 4.1 dhe 4.2 Shitesi Shyqyri Duraku heq dore nga pronesia mbi aksionet e cituara me larte dhe pronar i vetem e i ligjshem, me te drejta dhe detyrime te plota mbi aksionet objekt shitje i kesaj Kontrate, behet Bleresi Avni Ponari.

***Neni 6- Te ndryshme***

1. Kjo Kontrate ka fuqi ligjore per palet dhe pasuesit e tyre.
2. Kjo Kontrate, te drejtat dhe detyrime e paleve do te rregullohen, interpretohen dhe zbatohen ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Ne rast mosmarrveshje kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata e Rrethit Tirane.
3. Statutet e shoqerive "SIGAL" sh.a. dhe "SIGAL LIFE" sh.a. nuk parashikojne qe te jepet pelqimi i shoqerise per transferim pronesie mbi aksionet kur transferim kryhet ndermjet dy aksionereve aktual te shoqerise. Pavaresisht ketij fakti kjo shitje, per sa i perket aksionerit AAEF gezon pelqimin me shkrim konform mardhenieve kontraktore midis aksionereve te shoqerive objekt i kesaj Kontrate.
4. Per cdo gje jo te parashikuar shprehimisht ne kete Kontrate do te zbatohen dispozitat ligjore te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Kjo Kontrate u perpilua nga une noteri ne 4(kater) origjinale me te njejten vlere, dhe pasi lexohet nga palet e gjendet konform vullnetit tyre te lire e te plote nenshkruhet rregullisht.

**SHITESI**

**SHYQYRI DURAKU**

**NOTER**
**Robert KOLI**

**BLERESI**

**AVNI PONARI**